



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

---

**C.nr.679/15**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, trupi gjykues në përbërje nga gjyqtari Arsim Hamzaj - kryetari i trupit gjykues dhe gjyqtarëve porotë Eshref Qyse dhe Sejfullah Qesko - anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Kujtesa Uka, duke vendosur në *riprocedurë* sipas kërkesës nga kundërpadia e të paditurës - kundërpaditëses J. Q., e vajzërisë G. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.P. P. nga Prizreni, e parashtruar kundër paditësit - të kundërpaditurit B. Q. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.R. T. nga Prizreni, për shkak të mbajtjes finaciare - ushqimisë dhe kontributit për pasurinë e përbashkët bashkëshortore - ndarjes së pasurisë së përbashkët, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik, me datën 08.12.2015, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** kërkesa nga kundërpadia e të paditurës – kundërpaditëses J.Q. , e vajzërisë G. nga Prizreni, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet paditësi - i kundërpadituri B. Q. nga Prizreni, që në emër të mbajtjes finaciare - ushqimisë për të paditurën - kundërpaditësen, t'ia paguajë shumën prej 200 € në muaj, duke filluar nga muaji Maj 2013 deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, e cila pagesë do të bëhet për çdo muaj, e më së voni gjer me datën 5 të muajit rrjedhës si dhe që në emër të kontributit të paditëses për pasurinë e përbashkët bashkëshortore t'ia paguajë shumën prej 23,280.00 euro, të gjitha në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

### **A r s y e t i m**

Fillimisht paditësi - i kundërpadituri B. Q. nga Prizreni, të cilin me autorizim e ka përfaqësuar av.S. K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës - kundërpaditëses J. Q. e vajzërisë G. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. P.P. nga Prizreni, duke cekur se me të paditurën ka lidhur kurorë me 30.06.2009 në Prizren. Nga kjo martesë kanë lindur fëmijun e përbashkët F. Q., e cila pasi që bashkëshortët jetojnë ndaras, aktualisht jeton me babain e saj B. Q.. Në padi ka cekur se me të paditurën ka ndërprerë çdo kontakt dhe nuk jetojnë bashkë, pasi që paditësi që nga muaji korrik ka krijuar bashkësi të re

jashtmartesore, andaj edhe është bërë e pa mundur vazhdimi i bashkësisë martesore dhe ka kërkuar nga gjykata që të njejtën ta zgjidhë me shkurorëzim, ndërsa fëmiu i mitur F.Q. ti besohet në ruajtje kujdes dhe edukim babait-paditësit B. Q. .

Përgjatë shqyrtimit kryesor, i autorizuari i paditësit – të kundërpaditurit av. S. K. ka ngelur në tërësi si në padi dhe kërkesëpadi, ndërsa në fjalën e tij të fundit i ka propozuar gjykatës zgjidhjen e martesës, fëmiu i përbashkët i bashkëshortëve ti besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim të atit – këtu paditësit, ndërsa kontakti i fëmiut me të ëmën – këtu të paditurën të caktohet nga ana e gjykatës, ndërsa ka propozuar refuzimin e kërkesës nga kundërpadia lidhur me mbajtjen e të paditurës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 333 € dhe atë për 2 seanca nga 120 € dhe për përpilimin e padisë 93 €.

Kundër padisë së paditësit, e paditura J. Q. , ka parashtruar kundërpadi, përmes të cilës ka kërkuar pagesën e alimentacionit në shumën prej 200 € në muaj, që në emër të kontributit për pasurinë e përbashkët bashkëshortore, paditësi t'ia paguajë shumën prej 23.280 €, kontaktin me fëmiun e mitur të jetë çdo javë si dhe gjatë pushimeve verore dhe dimërore nga dy javë fëmiu ti kalojë te nëna si dhe shumën prej 550 €, në emër të shitjes së stolive personale.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, autorizuari i të paditurës – kundërpaditëses av. P. P. , ka mbetur në tërësi si në kundërpadi, ndërsa në fjalën e tij të fundit, ka precizuar kërkesën e kundërpadisë, duke e tërhequr kërkesëpadinë në pikën IV të kundërpadisë, nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket zgjidhjes së martesës, duke kërkuar pagesën e mbajtjes financiare-ushqimisë në shumën e kërkuar në kundërpadi si dhe kontaktet me fëmiun sipas vlerësimit të gjykatës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 333 € dhe atë për 2 seanca nga 120 € dhe për përpilimin e kundërpadisë 93 €.

Gjykata ka zhvilluar procedurën dhe në tërësi e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit - të kundërpaditurit ashtu që e ka zgjidhur me shkurorëzim martesën në mes bashkëshortëve, fëmiu i mitur F. Q., i është besuar në ruajtje, kujdes dhe edukim të atit - këtu paditësit - të kundërpaditurit, ndërsa kërkesa nga kundërpadia e të paditurës - kundërpaditëses J. Q. është aprovuar pjesërisht sa i përket mbajtjes financiare - ushqimisë dhe çështja e kontaktit është vendosur në çdo kohë dhe pa kufizim. Kërkesa në emër të shumës për shitjen e stolive është tërhequr, ndërsa sa i përket kërkesës lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët - kontributit të bashkëshortëve, është hudhur poshtë si e palejuar.

*Lënda me aktvendimin Ac.nr.352/14, të datës 25.05.2015 pjesërisht është kthyer në rigjykim nga ana e gjykatës së Apelit në Prishtinë sipas ankesës së palës së paditur-kundërpaditëses, me arsyetimin se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike sa i përket mbajtjes financiare të të paditurës – kundërpaditëses duke mos e përcaktuar nga e cila datë rrjedhë mbajtja si dhe sa i përket kontributit për pasurinë e përbashkët bashkëshortore, pasi që duhet të vërtetohen faktet se në çfarë mënyre manifestohet kjo shumë si pasuri e veçantë e paditëses në sende apo të holla. Ndërsa sa i përket zgjidhjes së martesës, besimit dhe kontaktit të fëmijës si dhe pjesës ku është konstatuar e tërhequr padia, aktgjykimi është vërtetuar*

Pas kthimit të lëndës nga ana e Gjykatës së Apelit në Prishtinë gjykata ka caktuar dhe mbajtur disa seanca, ndërsa seanca e fundit e shqyrtimit kryesor është mbajtur me datën

**08.12.2015, vetëm sa i përket çështjes së kërkesës nga kundërpadia e të paditurës - kundërpaditëses.**

Edhe në këtë seancë ( në rigjykim), i autorizuari i paditësit – të kundërpaditurit av.S. K. ka mbetur në tërësi pranë deklarimeve në shqyrtimet e kaluara sa i përket çështjes së alimentacionit ndërsa sa i përket çështjes së ndarjes së pasurisë së përbashkët – kontributit të bashkëshortve të njëjtën e ka kundërshtuar në tërësi. Ndërsa në fjalën përfundimtare të cilën gjykatës ia ka dorëzuar me shkrim i autorizuarai i paditësit – të kundërpaditurit av.R. T. nga Prizreni ka theksuar se sipas aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së dytë, Ac.nr.352/14 të dt.18.12.2013, çështja e divorcimit është përfunduar dhe tani objekti i kontestit në mes të palëve ndërgjyqëse ka të bëjë me kërkesëpadinë e paditëses J. Q. lidhur me vërtetimin e kontributit të saj në pasurinë e përbashkët gjatë jetesës bashkëshortore, duke theksuar se të njëjtën e mohon në tërësi. Padia e quajtur si kundërpadi nuk ka kurrfarë baze ligjore dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet në kuptim të një akti individual – juridik. Për të kërkuar sendet e fituara gjatë bashkëjetesës martesore duhet të ceken sendet nga bashkëpronësia. Vet fakti i krijimit të bashkëjetesës në bazë të martesës nuk jep të drejtën e rrogës mujore, siç është cekur në padi. Marrëdhëniet bashkëshortore nuk janë marrëdhënie punës për të siguruar pagën mujore. Vet fakti i jetesës bashkëshortore nuk e prodhon rritjen e pasurisë së përbashkët, prandaj pretendimi i padisë në këtë drejtim nuk ka ndonjë bazë juridike për të pranuar petitumin e padisë. Kontribut i rritjes së pasurisë nënkupton pasurinë e përbashkët nga fakti i ekzistimit të sendeve të luajtshme apo të palujtshme dhe me administrimin e provave është vërtetuar se nuk qëndron asnjë bazë juridike për vërtetimin e bashkëpronësisë të ndonjë pasurie e cila kishte me qenë në posedim të të paditurit B. Q. . Përkundrazi provat e propozuara nga pala paditëse si dhe deklaratat gjatë shqyrtimit vërtetojnë se ndërgjyqësit janë dakorduar për divorcim sipas traditës dhe dokjeve vendore pa i kërkuar asgjë njeri tjetrit. Në seancën kryesore të dt.18.11.2015, paditësja J. Q. ka theksuar se në ditën e shkurorizimit në prezencë të prindërit të vet ka marrë të gjitha sendet të cilat kanë qenë në posedim dhe përdorim të saj, i cili fakt është vërtetuar me dëgjimin e dëshmitarëve dhe dëgjimin e palëve ndërgjyqëse. Në mes të palëve nuk është kontestues fakti se ish bashkëshorti i paditëses B. në emër të tij nuk ka kurrfarë pasurie as të luajtshme e as të palujtshme, po ashtu nuk është kontestues fakti se i njëjti është i pa punë më shumë se dy vite dhe se jeton me prindërit e tij si dhe fakti se pasuria e të atit të paditurit B. rrjedhë nga trashëgimia e gjyshit të tij, andaj me ndarjen e bashkësisë martesore paditëses iu janë dhënë të gjitha sendet të cilat janë blerë me parat e familjes Q. , për paditësen J. . Duhet patur parasysh parasysh edhe dëshmitë e dëshmitarëve se në rastin konkret nuk ka dyshim se paditësja nuk ka dhënë kurrfarë kontributi për rritjen e pasurisë së përbashkët ngase një gjë e tillë edhe nuk ekziston, andaj pala paditëse nuk ka kurrfarë baze juridike për ngritjen e padisë dhe ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë.

I autorizuari i të paditurës - kundërpaditëses av.P. P. nga Prizreni, ka mbetur në tërësi si në theksimet në seancat e kaluara, ndërsa në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë kërkesëpadisë së parashtruar me kundërpadi, duke shtuar se e njëjta është argumentuar dhe provuar plotësisht, pasi që kjo është e drejtë e cila buron nga ligji dhe detyrimi i të paditurit për mbajtje dhe për kompensimin e pjesës së kontributit për rritjen dhe ngritjen e pasurisë së përbashkët është e drejtë e garantuar. Sa i përket lartësisë ka mbetur në tërësi pranë precizimeve të mëparshme duke konsideruar se shumtat e kërkuara në emër të kontributit për mbajtje, e edhe në emër të të kontributit për rritjen e pasurisë së përbashkët janë reale dhe në përputhshëri me koston e jetës

dhe me vlerat e pasurisë së të paditurit dhe në këtë drejtim i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e precizuar më parë ta aprovon në tërësi dhe ta obligon të paditurin që paditëses t'ia kompensojë në tërësi edhe shpenzimet e procedurës në shumën e precizuar në procesverbalin e seancës së mëparshme kryesore duke e shtuar edhe shumën për përfaqësime në 5 (pesë) seanca nga 135 euro.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat si në vijim: Çertifikatën e martesës me numër ... , të datës 24.07.2013, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prizren; ekstraktin e lindjes për të miturën F. Q., të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prizren më datë 24.06.2013; raportin e Qendrës për Punë Sociale në Prizren, nr. .... , të datës 10.10.2013 si dhe çertifikatën nr. .... , të lëshuar nga Zyra Komunale për Punë dhe Punësim – Prizren, datë 25.11.2013.

Përveq provave të lartcekura të cilat gjykata i ka administruar më parë, në rigjykim gjykata sipas propozimit të palëve ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarëve N. Q. dhe B. Q. , si dhe është bërë dëgjimi i palëve ndërgjyqëse B. Q. 1 dhe J. Q. në cilësi të palëve

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

**Kërkesa nga kundërpadia e të paditurës – kundërpaditëses është e pa bazuar.**

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitares N. Q., nga Prizreni, e cila para gjykatës ka theksuar se “këtu paditësja J. Q., ka kërkuar vet të largohet nga shtëpia, pasi që ka kërkuar të jetojë me burrin e saj në Slloveni, i cili ka qenë me vizë të përkohshme dhe nuk ka mundur të rregullojë dokumentacionin, ndërsa me rastin e ndarjes e njëjta ka marrë 7.000€ ari, dhe 10.000€ rroba, të cilat janë blerë me paratë nga shtëpia dhe vazhdimisht jemi kujdesur edhe gjatë kohës kur kanë jetuar në shtëpinë tonë duke dërguar në spitalet e ndryshme edhe pa dijeninë e djalit – ish burrit të saj. Në martesë kanë jetuar 11 vite dhe bashkëshortja – J. nuk ka punuar në ndonjë punë shtetit apo punë tjetër e njëjta ka pastruar ndërsa punët më të mëdhaja i kam kryer unë së bashku me rejen e madhe”.

Gjykata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit B. Q., nga fsh. .... , Komuna e Prizrenit, i cili ka theksuar se “ me rastin e ndarjes – shkurorezimit ka qenë prezentë bashkëshortet dhe axha i B. dhe të njëjtit janë ndarë pa ndonjë fjalë dhe nuk është vendosur për ndonjë dëmshpërblim apo kontribut për pagesën e nuses, ku nga ana e nuses kanë marrë pjesë babai dhe vëllai i nuses dhe janë ndarë sipas traditës”.

Gjykata ka bërë dëgjimin në cilësi të palës për të paditurën - kundërpaditësen J. Q. e cila ka theksuar se “kanë jetuar afër 12 vite, në bashkësi martesore me B. Q. dhe si çdo nuse kur është martuar ka bërë punët e shtëpisë mirëpo përveç kësaj pasi që shtëpia ka qenë e pa rregulluar pa kanalizim ka ndihmua gjatë rregullimit të shtëpisë duke bartur dheun, gurë së bashku me vjehrrin, e vazhdimisht ka punua punë të ndryshme deri në rregullimin e shtëpisë dhe oborrit dhe pasi është rregulluar oborri me kubëza e kanë larguar nga shtëpia, po ashtu ka shtuar se vazhdimisht është kujdesur për rritjen e vajzës pasi që B. ka jetuar në grybet si dhe ka kryer gjitha punët duke fshirë, gatuar dhe duke u kujdesur për bagëtinë. Pas ndarjes faktike me

bashkëshortin ka jetuar në shtëpinë e familjes së saj ndërsa tani para 2 jave ka krijuar bashkësi të re martesore”.

Gjykata ka bërë dëgjimin në cilësi të palës për paditësin – të kundërpaditurin B. Q., i cili ka theksuar se “11 vjet e gjysëm ka jetuar në bashkësinë martesore dhe bashkëshortja ka punuar normal me pastrimin e shtëpisë, kujdesin e vajzës, ndërsa nuk është marr me punë tjera si në gatim pasi që për këtë është kujdesur nëna dhe nusja e vëllait të madhë, duke shtuar se dy vitet e para të martesës ka jetuar në Kosovë dhe pas kësaj ka shkua në Gyrbet ku ka ardhur për pushime çdo të dytin apo të tretin muaj ku ka qëndruar deri në një muaj pushim. Po ashtu ka theksuar se me rastin e martesës gjendja ekonomike ka qenë shumë e dobët pastaj është rregulluar dhe diku 5-6 muaj para ndarjes gjendja është keqësuar ku kanë pasur humbje për afërsisht 400 mijë euro dhe tani personalisht i njëjti ka borxhë diku 120 mijë euro. Për kohën sa kemi jetuar bashkë është kujdesur vazhdimisht për gjithçka çka nevojitet për jetën, ndërsa pas ndarjes ka theksuar se ndoshta është dashur ti ndihmojë diçka bashkëshortes, mirëpo këtë e ka të pamundur për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike pasi që në emrin e tij nuk ka pasuri e asë që ka pasur sepse i gjithë fitimi që kanë pasur në Slloveni e kanë humbur dhe tani e financon vëllau për shkak se që dy vite nuk punon”.

Sipas nenit 298 par.1 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK) është e paraparë se *“bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose për arsye tjera nuk mund të punësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundësitë e tij financiare”*. Përfundimisht me nenin 299 të këtij ligji, në mënyrë decisive është paraparë se *“bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqiminë nga bashkëshorti tjetër përderisa ai të kujdeset dhe e mbanë fëmiun e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punojë”*.

Me nenin 47 par.1 të LFK-së parashihet se *“Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuri e tillë”*. Në nenin 52 të LFK-së parashihet se *“Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij”*. Me nenin 54 par .1 të LFK-së parashihet se *“Nëse nuk arrihet marrëveshje në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve,.....”*. Me nenin 56 par. 1 të LFK-së parashihet se *“Ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkojë gjatë martesës dhe pas pushimit të saj”*. Poashtu edhe në neni 89 të LFK-së parashihet se *“Pjesëtimi pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkojë gjatë martesës dhe pas mbarimit të saj me shkurorëzim”*.

Në bazë të provave të administruara, në rigjykim gjykata gjeti se kërkesa nga kundërpadia e të paditurës – kundërpaditëses J. Q. është e pa bazë dhe si e tillë duhet të refuzohet në tërësi, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkeës nga kundërpadi lidhur me mbajtjen financiare – ushqiminë, gjykata të njëjtën e refuzoi si të pa bazë, pasi që me provat e administruara ka vërtetur se nu ka bazë për aprovimin e së njëjtës duke marrë parasysh faktin se këtu e paditura – kundërpaditësjja si ish bashkëshorte nuk është në atë gjendje që ti caktohet ushqimia, pasi që edhe qëllimi i ushqimisë është që të mbrojë personalitetin e ish bashkëshortit lidhur me plotësimin e nevojave dhe

kërkesave të domosdoshme, e të cilat ish bashkëshortja i plotëson në mënyrë tjetër sepse nga gjykata është vërtetuar se e njejtë tani është në marrëdhënie pune, e poashtu edhe ka krijuar edhe bashkësi të re martesore (të cilin fakt vet e paditura – kundërspaditësja e ka deklaruar gjatë shqyrtimit kryesor). Poashtu lidhur me këtë gjykata në riprocedurë ka vërtetuar se edhe ish bashkëshorti këtu paditësi - i kundërspadituri nuk ka mjete për dhënien e ushqimisë, pasi që i njejtë është i papunë, ka borxhe të mëdha dhe nuk është në gjendje të jep ushqimi, bazuar në nenin 307.1 të LFK-së, (vlen të ceket se edhe ky fakt nuk është kontestues nga ana e palëve). Këtij vlerësimi të gjykatës i kontribon edhe fakti se ish bashkëshorti ndaj të cilit kërkohet dhënia e ushqimisë, tani ka krijuar edhe bashkësi të re martesore, e sidomos fakt shumë me rëndësi për gjykatën është se të njejtë i është besuar edhe ruajtja kujdesi dhe edukimi i fëmijës së përbashkët nga martesë me ish bashkëshorten këtu të paditurën – kundërspaditësen (në të cilën pikë aktgjykimi është vërtetuar), për të cilin ka edhe obligime financiare shtesë lidhur me rritjen dhe edukimin e saj, e që eventualisht caktimi i shumës për ushqimi do të ndikonte që të rrezikohej në ekzistencën e të paditurit dhe fëmiut të mitur. Si fakt me rëndësi për gjykatën është edhe parimi kryesor i ushqimisë e që ka të bëjë me atë se **ushqimia çdoherë jepet për kohën e ardhshme**, e që ka të bëjë me sigurimin e mjeteve të nevojshme për ekzistencë, e jo pasurim i personit.

Sa i përket kërkesës nga kundërspadia lidhur me kontributin e përbashkët për rritjen e pasurisë së përbashkët, nga provat e administruara gjykata ka vlerësuar se një kërkesë e tillë është e pabazë, për faktin se lidhur me këtë pala e paditur – kundërspaditëse gjykatës nuk i ka ofruar asnjë provë lidhur me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve. Sipas vlerësimit të gjykatës e duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Familjen i Kosovës si pasuri e përbashkët e bashkëshortëve konsiderohet pasuria e cila është fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës si dhe të hyrat që rrjedhin nga kjo pasuri, e cila krijohet me kontributin e bashkëshortëve në mënyrë të tërthortë (kujdesi për fëmijë, punët e shtëpisë) apo të drejtëpërdrejtë (paga). Mirëpo në bazë të provave të administruara në këtë procedurë është konstatuar se në momentin e shkëputjes së bashkësisë martesore gjykata nuk ka mundur të konstatojë se ish bashkëshortët kanë pasur pasuri të përbashkët në mënyrë që të bëhet pjestimi i kësaj pasurie apo vlerësimi i kontributit që kërkohet nga ana e palës së paditur – kundërspaditëse, pasi që për këtë nuk ka ofruar asnjë provë të vetme edhe pse është ftuar nga gjykata që të parashtrojë prova.

Vlen të ceket se me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se ***“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”***, andaj përgjatë tërë zhvillimit të procedurës, gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse.

Poashtu sipas vlerësimit të gjykatës një kërkesë e tillë siç është formuluar është e pa bazë, pasi që është kërkuar shuma prej 23,280.00 euro, sepse pjesëtimi i pasurisë së përbashkët bëhet në atë mënyrë që caktohet masa e llogarisë së përbashkët, e cila llogaritet sipas kontributit të secilit bashkëshort, duke marrë për bazë gjendjen e pasurisë në momentin e mbarimit të martesës, e që në këtë procedurë është vërtetuar se këtu ish bashkëshortët fare nuk kanë pasuri të përbashkët, pasi që bashkëshorti gjatë dëgjimit në cilësi të palës ka deklaruar se 6 muaj para se të përfundojë ndarja faktike e martesës kanë humbur të gjithë pasurinë dhe nuk kanë asnjë pasuri në emër të tyre, të nejtin është duke e mbajtur vëllai i tij, ka personalisht 120,000.00 euro borxh, (të cilin fakt edhe nuk e ka kundërshtuar vet pala e paditur – kundërspaditësja). Poashtu sa i përket

kërkesës së Gjykatës së Apelit që të vërtetohet se kjo pasuri a kërkohet si pasuri e veçantë e të paditurës – kundërpaditëse apo si pasuri e përbashkët e krijuar gjatë martesës, në procedurë gjykat e vërtetoi dhe kjo pasuri kërkohet si kontribut për shtimin e pasurisë së përbashkët gjatë martesës pasi lidhur me pasurinë e veçantë të ish bashkëshortes është vërtetuar se e njejta me rastin e ndarjes faktike të bashkësisë martesore ka marrë të gjitha sendet personale të cilat i kanë takuar asaj, e të cilën poashtu nuk e ka mohuar e paditura – kundërpaditësja. Është vlerësim i gjykatës se vetëm ekzistimi i bashkësisë martesore nuk nënkupton rritjen e pasurisë së përbashkët, e as të drejtën për të kërkuar ndarjen e pasurisë së përbashkët, kur kjo nuk ekziston.

Mbi bazën e të lartcekurave dhe duke qenë se kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesë për mbajtje finaciare - ushqimi dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët - kontributit, si dhe faktit se e paditura - kundërpaditësja nuk ka parashtruar asnjë provë materiale të vetme, përmes të cilave do të argumentohet e drejta e saj, edhe pse për këtë në seancën e shqyrtimit kryesor është ftuar nga ana e gjykatës që të propozojë prova të reja, pasi që *barra e të provuarit* lidhur me këto pretendime i ka takuar asaj, kjo gjykatë nuk mundi ta aprovojë kërkesën nga kundërpadia, respektivisht të njëjtën u deshtë që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit në Prishtinë në riprocedurë ka zhvilluar procedurën (*edhe pse qëndrimi i Gjykatës së Apelit në aktvendimin CA.nr.4153/14, të datës 02.12.2014 se gjykata nuk e ka caktuar nga cila date do të rrjedhë mbajtja dhe se gabimisht është është interpretuar dispozita e nenit 89 i LFK-së*) **ka qenë jo i drejtë dhe i pabazuar**, pasi që në Aktgjykimin e mëparshëm është cekur që pagesa për ushqimi të fillojë 15 ditë pas marrjes së aktgjykimit, *e që parim kryesor i ushqimisë është që e njejta caktohet për kohën e ardhshme*, ndërsa sa i përket pjesëtimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve sipas dispozitës së lartcekur kjo mund të bëhet gjatë martesës dhe pas mbarimit të saj që do të thotë pas shkurorëzimit, e që tani në riprocedurë gjykata ka vendosur, pasi që aktgjykimi lidhur me shkurorëzimin e martesës është vërtetuar në këtë pikë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar në dispozitat e nenit 452.4 të LPK-së dhe nenit 347 të LFK-së, pasi që e paditura - kundërpaditësja i ka kërkuar shpenzimet, mirëpo a ka pasur sukses në gjykim, ndërsa paditësi – i kundërpadituri nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.679/15, datë 08.12.2015**

Sekretarja juridike  
Kujtesa Uka

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Arsim Hamzaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.